



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Kodi i lëndës: INF 140
Lënda: Histologjia dhe Mikrobiologjia

PROGRAMI I LËNDËS								
Histologjia dhe Mikrobiologjia								
Titullari / pedagogu i lëndës		Ela Peto Dr. në Mjekësi Paraklinike _____						
Ngarkesa:	ECTS	Orë mësimi në auditor					Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Lab	Praktikë	Projekt klinik		
	8	45	20	9	0	1	125	200
Tipologjia e lëndës		Disiplinë e formimit karakterizues të programit						
Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti I, Semestri I						
Lloji i lëndës		E detyrueshme						
Programi i studimit		Bachelor në "Infermieri të përgjithshme"						
Kodi i lëndës		INF 140						
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës		ela.peto@univlora.edu.al , petoela@yahoo.com						

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
Përmbledhja	Histologjia bën pjesë në lëndët paraklinike dhe ndihmon studentin të marrë njohuri bazë për ndërtimin e trupit të njeriut, duke filluar studimin që nga qeliza. Nëpërmjet mikrobiologjisë studenti merr njohuri për mikroorganizmat që invadojnë trupin e njeriut dhe e ndihmon për të kuptuar më mirë patologjitë infektive.
Objektivat e lëndës	Në përfundim të këtij kursi studentët do të kenë njohuri në drejtim të <ul style="list-style-type: none">▪ Njohja me indet baze të organizmit të njerit.▪ Njohja me qelizat prej të cilave është formuar indi epitelial, indi lidhor, indi limfoid, indi mieloid, qelizat e aparatit respirator, tretës, sistemit endokrin, organeve riprodhuese.▪ Njohja me bakteret dhe viruset, infeksionet dhe shkaktaret mikrobiale të tij.
Rezultatet e të nxënit	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none">☞ Të njohin ndërtimin e qelizave, indeve dhe organeve të trupit të njeriut.☞ Të njohin mikroorganizmat gjalla që invadojnë trupin e njeriut, llojet e infeksionit dhe sëmundjet e tyre.☞ Të njohin reaksionet mbrojtëse të organizmit të njeriut, imunitetin jospesifik dhe specifik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

KONCEPTET THEMELORE

1. Histologjia si shkencë.
2. Studimi në nivel mikroskopik të qelizave dhe indeve të organizmit të njeriut.
3. Studimi i mikroorganizmave që invadojnë trupin e njeriut.
4. Imuniteti.

Java	Temat teorike: leksione	Nr i faqes ne literaturë bazë	Forma e mësimdhënies
I	<p>Tema 1 - Histologjia, objekti, historiku, metodat e studimit. <i>Histologjia është shkencë që meret me studimin mikroskopik të indeve.</i> <i>Metodat e studimit mikroskopik; përgatitja e preparateve histologjike</i></p> <p>Tema 2 - Citologji, njohuri të përgjithshme për qelizat, membrana qelizore <i>Qeliza; ndërtimi i saj, modelet e organizimit të qelizës; funksionet e cipës qelizore.</i></p> <p>Tema 3 - Citologji, organelet qelizore. <i>Organelet qelizore janë ribozomet, REP, mitokondret, lizozomet, aparati i Golxhit</i></p> <p><i>Seminar 1: Histologjia, objekti, historiku, metodat e studimit.</i> <i>Seminar 2: Citologji, njohuri të përgjithshme për qelizat, membrana qelizor, organelet</i></p>	<p>¹Fq. 7 – 19</p> <p>¹Fq. 19 – 26</p> <p>¹Fq. 27 - 37</p>	<p>Leksion 3 orë</p> <p>Seminar 2 orë</p>
II	<p>Tema 4 - Bërthama <i>Bërthama është organel thelbësor i qelizës që ndërtohet nga cipa bërthamore, kromatina dhe kromozomet, lëngu bërthamor, bërthamëzat.</i></p> <p>Tema 5 – Indi epitelial <i>Indi epitelial është një nga katër indet bazë të organizmit. Ndërton lëkurën dhe mukozat e organeve të brendshme, cipat seroze.</i></p> <p>Tema 6 – Indi lidhor <i>Indi lidhor ndërton submukozat e organeve të brendshme dhe bën lidhjen ndërmjet indeve të tjera.</i></p> <p><i>Seminar 3 – 4: Indi epitelial, Indi lidhor.</i></p>	<p>¹Fq. 39 – 46</p> <p>¹Fq. 47 – 62</p> <p>¹Fq. 63 – 74</p>	<p>Leksion 3 orë</p> <p>Seminar 2 orë</p>
III	<p>Tema 7 - Gjaku. <i>Gjaku përbëhet nga qelizat eritrocitet leukocitet, trombocitet dhe plasma e gjakut.,</i></p> <p>Tema 8 – Indi mieloid, palca e kockave <i>Palca e kockave është ind hemopotetik, ndërtohet nga stroma dhe parenkima me qeliza gjaku në stadi të ndryshme diferencimi.</i></p> <p>Tema 9 – Hemopoeza <i>Është procesi i formimit të qelizave të pjekura të gjakut. Përbëhet nga eritropoeza, leukopoeza, trombopoeza.</i></p> <p><i>Seminar 5 - 6: Indi mieloid, palca e kockave.</i></p>	<p>¹Fq. 75 – 86</p> <p>¹Fq. 87 – 92</p> <p>¹Fq. 92 – 100</p>	<p>Leksion 3 orë</p> <p>Seminar 2 orë</p>
IV	<p>Tema 10 – Indi limfoid, timusi dhe nyjet limfatike. <i>Timusi është organ limfoepitelial/. Në të bëhet maturimi i limfociteve T dhe luan një rol të rëndësishëm në imunitet.</i></p>	<p>¹Fq. 101 – 107</p>	<p>Leksion 3 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<p>Nyjet limfatike bëjnë qarkullimin limfocitar, kanë funksione imunologjike, filtrimin e limfës.</p> <p>Tema 11 – Indi limfoid, shpretka <i>Shpretka është organ me funksion imunitar, formohet nga stroma dhe parenkima, nga pulpa e bardhë dhe pulpa e kuqe.</i></p> <p>Tema 12 – Indi kërcor dhe indi kockor. <i>Indi kërcor formohet nga kondrocitet dhe elementët fijos.</i> <i>Indi kockor formohet nga osteocitet, qelizat osteoprogenitore, osteoblaste osteoklaste dhe matrixi organik dhe inorganik.</i></p> <p>Seminar 7 - 8: Indi limfoid, timusi dhe nyjet limfatike. <i>Indilimfoid, shpretka.</i></p>	<p>¹Fq. 107 – 112</p> <p>¹Fq. 113 - 121</p>	<p>Seminar 2 orë</p>
V	<p>Tema 13 – Indi muskular. <i>Indi muskular formohet nga muskulatura e vijëzuar e skeletit dhe muskulatura e lëmuar e organeve të brendshme. Një nëntip special është muskulatura e zemrës</i></p> <p>Tema 14 – Indi nervor. <i>Indi nervor ndërtohet nga neuronet dhe qelizat e neuroglisë.</i></p> <p>Tema 15 – Enët e gjakut. <i>Enët e gjakut janë arteriet, kapilarët dhe venat. Muri i tyre ndërtohet nga endoteli, muskulatura dhe indi lidhor.</i></p> <p>Seminar 9 - 10: Indi muskular, indi nervor;</p>	<p>¹Fq. 123 – 132</p> <p>¹Fq. 133 - 146</p> <p>¹Fq. 147 - 151</p>	<p>Leksion 3 orë</p> <p>Seminar 2 orë</p>
VI	<p>Tema 16 – Zemra <i>Histologjikisht zemra ndërtohet nga 3 shtresa: endokardi, miokardi dhe epikardi dhe vishet nga jashtë nga perikardi.</i></p> <p>Tema 17 – Sistemi respirator, kaviteti nazal, laringu, faringu trakea. <i>Kaviteti nazal formohet nga mukoza respiuratore, olfaktore dhe vestibulare.</i> <i>Laringu faringu dhe trakea formojnë rrugët respiratore dhe ndërtohen histologjikisht nga mukozat submukoza, muskulatura adventicia me specifika të veçanta për secilën.</i></p> <p>Tema 18 – Sistemi respirator, pema bronkiale, mushkrittë. <i>Mushkrittë formohen histologjikisht nga stroma prej indi lidhor dhe parenkima nga alveolat. Pema bronkiale ndërtohet nga bronket ekstrapulmonare , intrapulmonare dhe bronkiolat</i></p> <p>Seminar 11 - 12: Zemra, Sistemi respirator</p>	<p>¹Fq. 151 – 158</p> <p>¹Fq. 159 - 165</p> <p>¹Fq. 165 - 172</p>	<p>Leksion 3 orë</p> <p>Seminar 2 orë</p>
VII	<p>Tema 19 – Aparati tretës, gjuha, tonsilat dhe gjëndrat e pështymës. <i>Gjuha është një organ muskulogjëndror.</i> <i>Tonsilat formohen nga indilimfoid.</i> <i>Gjëndrat e pështymës formohen nga indi epitelial. Janë gjëndra ekzokrine.</i></p> <p>Tema 20 – Aparati tretës, ezofagu, stomaku, zorrët. <i>Ezofagu ndërtohet nga mukoza, submukoza, muskulatura adventicia</i> <i>Stomaku ndërtohet nga gjëndrat kardiale, të fundusit dhe trupit dhe gjëndrat pilorike.</i> <i>Ndërtimi histologjik i zorrës: mukoza, submukoza, muskulatura dhe seroza.</i></p> <p>Tema 21 – Aparati tretës, mëlçia.</p>	<p>¹Fq. 173 – 187</p> <p>¹Fq. 197 - 208</p> <p>¹Fq. 209 - 213</p>	<p>Leksion 3 orë</p>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI VLORË”
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<p>Mëlçia ndërtohet nga: stroma prej indi lidhor dhe parenkima nga hepatocitet. Histologjikisht organizohet në lobulin klasik, lobulin portal dhe acinusin</p> <p>Seminar 13 – 14: Aparati tretës: gjuha, tonsilat dhe gjëndrat e pështymës, ezofagu, stomaku, zorrëtMasat parandaluese të infeksioneve: larja e duarve, veshja e dorezave sterile, përdorimi i maskës dhe përparësës me një përdorim</p>		Seminar 2 orë
VIII	<p>Tema 22 – Aparati tretës, pankreasi. Njësia strukturre e pankreasit është acinusi. Pankreasi endokrin formohet nga ishujt e langerhansit</p> <p>Tema 23 – Gjëndrat me sekretim të brendshëm, hipofiza dhe gjëndra tiroide. Hipofiza ndërtohet nga adenohipofiza dhe neurohipofiza. Adenohipofiza përbëhet nga qelizat somatotrope, laktrotrope, tirotrope dhe gonadotrope kortikotrope. Tiroidia ndërtohet nga folikulat, qelizat folikulare dhe parafolikulare.</p> <p>Tema 24 – Gjëndrat me sekretim të brendshëm, gjëndra paratiroide dhe gjëndrat mbiveshkore. Gjëndrat paratiroide ndërtohet nga stroma dhe parenkima. Gjëndrat mbiveshkore histologjikisht ndërtohet nga korteksi dhe medula.</p> <p>Seminar 15 – 16: Mëlçia, pankreasi, gjëndrat me sekretim të brendshëm.</p>	<p>¹Fq. 213 – 216</p> <p>¹Fq. 217 - 224</p> <p>¹Fq. 224 - 228</p>	Leksion 3 orë
IX	<p>Tema 25 – Aparati urinar, histologjia e veshkës, nefroni. Veshka histologjikisht ndërtohet nga stroma dhe parenkima, korteksi dhe medula, lobi dhe lobulet, piramidat dhe kalicet renale. Njësia strukturore e veshkës është nefroni. Ndërtohet nga glomeruli dhe tubulat renale.</p> <p>Tema 26 – Lëkura Lëkura histologjikisht ndërtohet nga derma, epiderma dhe hipoderma.</p> <p>Tema 27 – Syri. Syri histologjikisht ndërtohet nga 3 shtresa: nervore (retina), vaskulare (koroidea, trupi ciliar, irisi) dhe fibroze (sklera kornea).</p> <p>Seminar 17 - 18: Aparati urinar, histologjia e veshkës, nefroni, lëkura, syri.</p>	<p>¹Fq. 229 - 239</p> <p>¹Fq. 239 - 247</p> <p>¹Fq. 267 - 277</p>	Leksion 3 orë
X	<p>Tema 28 – Veshi. Veshi i jashtëm : lapa e veshit, kanali i jashtëm i dëgjimit. Veshi i imesëm: membrana timpanike kockezat dëgjimore; Veshi i brendshëm : labirinthe kockor, labirinthe cipor, vestibuli, koklea.</p> <p>Tema 29 – Sistemi riprodhues femëror Vezoret ndërtohen nga stroma dhe parenkima me folikulat. Mitra ndërtohet histologjikisht nga endometri, miometri, perimetri.</p> <p>Tema 30 – Sistemi riprodhues mashkullor Testet formohen nga stroma dhe parenkima me gypa seminifer.</p>	<p>¹Fq. 277 - 286</p> <p>¹Fq. 247 - 257</p> <p>¹Fq. 257 - 267</p>	Leksion 3 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<p><i>Qelizat janë qeliza spermatogjene, qelizat e sertolit të ledingut etj. Sistemi i gypave janë: gypat eferent, epididimi, deferent dhe ejakulator.</i> <i>Prostata është organ muskulo gjëndror.</i> Seminar 19 - 20: Veshi, Sistemi riprodhues femëror dhe mashkullor.</p>		Seminar 2 orë
XI	<p>Tema 31 – Hyrje në Mikrobiologji. <i>Mikrobiologjia është shkenca që meret me studimin e mikroorganizmave që invadojnë trupin e njeriut.</i> Tema 32 – Qelizat eukariote dhe prokariote. <i>Qelizat eukariote janë qeliza me berthame.</i> <i>Qelizat prokariote janë qeliza pa berthame.</i> Tema 33 – Qeliza bakteriale. <i>Bakteriet janë mikroorganizam kryesojnë që shkaktojnë patologji në trupin e njeriut.</i> Seminar 21 - 22: Mikrobiologjia, qelizat eukariote dhe prokariote, qelizat bakteriale</p>	<p>²Fq. 5 – 13 ²Fq. 25 - 40 ²Fq. 49 - 60</p>	Leksion 3 orë Seminar 2 orë
XII	<p>Tema 34 – Viruset. <i>Viruset klasifikohen sipas materialit gjenetik, strehuesit që ai infekton, llojit të sëmundjes që shkakton.</i> Tema 35 – Protozoarët dhe kërpudhat. <i>Protozoarët janë mikroorganizma eukariot, njëqelizore ku bën pjesë amebat, flagjelatët, protozoarët e palëvizshëm.</i> <i>Kërpudhat janë mikroorganizma eukariot që shkaktojnë sëmundjet mukozale.</i> Tema 36 – Fiziologjia e mikroorganizmave. <i>Mikroorganizmat klasifikohen në varësi të kërkesave ushqimore: heterotrofë autotrofë, fototrofë dhe litotrofë</i> Seminar 23 - 24: Viruset; Protozoarët: kërpudhat dhe algat, fiziologjia e mikroorganizmave.</p>	<p>²Fq. 60 – 68 ²Fq. 68 - 77 ²Fq. 79 - 85</p>	Leksion 3 orë Seminar 2 orë
XIII	<p>Tema 37 – Rritja e bakterieve. <i>Rritja e baktyrieve përcaktohet nga shtimi i numrit të mikroorganizmave dhe vlerësohet nëpërmjet kurbës së rritjes së bakterieve.</i> Tema 38 – Gjenetika bakteriale. <i>Mutacionet janë ndryshime në gjenetikën bakteriale dhe bëjnë pjesë konversioni, transduksioni, transformimi, konjugimi.</i> Tema 39 – Mikroflora normale e trupit të njeriut. <i>Mikroflora normale përfshin të gjithë mikroorganizmat që gjenden brenda trupit të njeriut dhe nuk shkaktojnë patologji. Këtu futet mikroflora e lëkurës, gojës, aparatit tretës, urinar, respirator.</i> Seminar 25 - 26: Rritja e bakteve. Gjenetika bakteriale. Mikroflora normale e trupit të njeriut</p>	<p>²Fq. 97 – 106 ²Fq. 106 - 112 ²Fq. 114 - 126</p>	Leksion 3 orë Seminar 2 orë
XIV	<p>Tema 40 – Faktorët që ndikojnë në rritjen e bakterieve. <i>Faktorët që ndikojnë në rritjen e bakterieve janë temperatura, agështira, presioni osmotik, pH, presioni i pjesshëm i gazeve .</i> Tema 41 - Metodat antimikrobiale fizike dhe kimike. <i>Metodat antimikrobiale janë: metodat fizike, kimike.</i> Tema 42 – Infeksioni dhe shkaktarët mikrobiale të tij. <i>Aftësia e një mikrobi patogjen për të infektuar dhe shtuar</i></p>	<p>²Fq. 129 – 136 ²Fq. 137 - 150 ²Fq. 164 - 179</p>	Leksion 3 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<p><i>strehuesit, për të shkaktuar dëmtime dhe për të provokuar sëmundje quhet virulencë. Graviteti i infeksionit varet nga virulenca mikrobiale dhe mbrojtja e strehuesit.</i></p> <p>Seminar 27 - 28: Faktoret që ndikojnë në rritjen e baktereve. Metodat antimikrobiale fizike dhe kimike. Infeksioni dhe shkaktaret mikrobiale të tij</p>		Seminar 2 orë
XV	<p>Tema 43 – Epidemiologjia dhe transmetimi i sëmundjes <i>Epidemiologjia është shkencë që studjon shpeshësinë dhe shpërndarjen e sëmundjes dhe faktorët që ndikojnë në përhapjen e infeksioneve.</i></p> <p>Tema 44 – Imuniteti jospecifik. <i>Në imunitetin jospecifik futet: linja e parë e mbrojtjes (barrierat kimike, fizike, mikroflora normale), linja e dytë e mbrojtjes (interferoni, komplementi, fagocitoza), reaksioni inflamator.</i></p> <p>Tema 45 – Imuniteti specifik. <i>Imuniteti specifik përbëhet nga imuniteti i fituar pasi dhe aktiv, natyral dhe artificial.</i></p> <p>Seminar 29 -30: Epidemiologjia dhe transmetimi i sëmundjes. imuniteti jospecifik dhe specifik</p>	<p>²Fq. 180 – 193</p> <p>²Fq. 214 - 226</p> <p>²Fq. 227 - 247</p>	<p>Leksion 3 orë</p> <p>Seminar 2 orë</p>

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:	<p>Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e laboratorit janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e seminarit në orarin e përcaktuar (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>					
Mënyra e vlerësimit	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi I	Java 7/8	1-15 leksione	30 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Provimi përfundimtar	Fundi i semestrit	16 – 45 leksione	60 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar*	Java 14/15	Temat e seminarit	10 pikë	Realizim procedurash në laborator	Demostrim procedure
	*Vlerësim i vazhduar - Do të realizohet prej pedagogut të seminarit për gjatë gjithë semestrit.					
Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë:						
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
	5	6	7	8	9	10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

LITERATURA	
Literatura bazë e detyruar	<ol style="list-style-type: none">1. "Histologjia, 2015. Alb Paper Tiranë ISBN – 978 – 99956-34-91-9 Prof. Dr. Xheladin Ceka.2. "Mikrobiologjia e përgjithshme" 2014 Prof. Betim Byku. ISBN 99927-830-8-7
Literatura e rekomanduar	<ul style="list-style-type: none">○ "Atlas i histologjise " Prof.Elsa Kone, Prof.Dr.Xheladin Ceka○ "Histologjia " Xheladin Ceka (Fakulteti i Mjekësisë-UT)○ "Mikrobiologjia" B.Andoni, Betim Byku (Fakulteti i Mjekësisë-UT)

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS	
Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuar.
Vonesat	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penaltete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit dhe të Fakultetit të Shëndetit Publik.
Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	Çdo test apo pune me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të ë gjithnje burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETTIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË
